



REPUBLIKA E KOSOVËS



PLANI PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATÛRORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT 2017-2020



SHKURT 2017

“Çdokush, individualisht ose në mënyrë kolektive, ka të drejtë të përfitojë nga trashëgimia kulturore dhe të kontribuoj për pasurimin e saj”

Seksioni I, Neni 4, a. Konventa kuadër e Këshillit të Evropës për vlerën e trashëgimisë kulturore për shoqërinë - Faro, 27 tetor 2005.

VËREJTJE HYRËSE

Plani për ruajtjen, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm ekonomik të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Komunës së Lipjanit për periudhën 2017 - 2020 , është inicuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, Vendimi.....2015, me qëllim të shqyrtimit dhe analizimit të sistemit ekzistues të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore përkatësisht, shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë dhe përcaktimi i objektivave, masave dhe aktivitetet kështu që, trashëgimia kulturore dhe potencialet e saj, të shfrytëzohen me sukses dhe efikasitet, si resurs zhvillimor në parim të zhvillimit të qëndrueshëm.

Plani përmbanë drejtimet dhe masat si kornizë për projekte konkrete zhvillimore, për shfrytëzim të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore.

Për shkak se fenomeni i shfrytëzimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore është mjaftë kompleks dhe se ky Plan hartohet për herë të parë, për zbatimin e tij kërkohet një bashkëpunim i ngushtë ndërsektorial.

Kjo siguron që, Plani është në përputhje dhe koherent , relevant dhe mbi të gjitha, mbështet në parimin e qëndrueshëm, efektiv dhe efikas dhe kontribuon në zhvillimin e tërësishëm të Komunës së Lipjanit.

Përmbajtja

4 Parathënie.

8 Programi i Planeve Lokale të Trashëgimisë Kulturore 2012-15.

14 Metodologjia e hartimit të Planeve Lokale të Trashëgimisë Kulturore.

19 Analizë mbi gjendjen ekzistuese të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunën e Lipjanit.

28 Lista e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme në Lipjan.

58 Analiza SWOT për Komunën e Lipjanit.

80 Objektivat e përgjithshme dhe priorizimi i projekteve.

89 Periudha e konsultimeve publike.

90 Prioritetet dhe projektet e identifikuar në Komunën e Lipjanit.

105 Zbatimi i projekteve.

106 Bibliografia.

107 Lista e figurave.

108 Ekipi i programit dhe i publikimit.

QELLIMI DHE OBJEKTIVAT

Plani Lokal i Trashëgimisë Kulturore, do të identifikoj resurset e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunë, dhe do të shërbejë si bazë për zhvillim ekonomik dhe social të komunitetit. Ky plan, do të marr formën e një liste me aktivitete-projekte, si rezultat i bashkërendimit të prioriteteve të grupeve të ndryshme të interesit, të kyçura në proces, me prioritetet e komunës në kuadër të zhvillimit lokal, nëpërmjet trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Nëpërmjet Planit Lokal të Trashëgimisë Kulturore, do të adresohen nevojat e menjëhershme dhe njëkohësisht, do të skicohet një vizion më afatgjatë, për trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Objektivi i përgjithshëm i Planit, është të kontribuojë në përforcimin e rolit të Komunës, OJQ-ve dhe komuniteteve, në ruajtjen dhe revitalizimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore lokale dhe shfrytëzimin e saj të qëndrueshëm, në shërbim të zhvillimit lokal.

Objektivi tjetër kryesor është sinergia e veprimeve të gjithë akterëve të nivelit qendror, komunal dhe të komunitetit, që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Qëllimi i Planit, është të përmirësojë gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunë, të ndihmojë në integrimin e saj efektiv në kontekstin e planifikimit urban, si dhe të lehtësojë integrimin e saj në qarqet ekonomike, turistike e kulturore lokale.

Një faktor i rëndësishëm i arritjes së këtyre qëllimeve është, edhe bashkëpunimi i ngushtë me institucionet qendrore, si Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe organizatat ndërkombëtare sikurse UN HABITAT-i, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), etj.

Metodologjia - Në mënyrë që të plotësohen objektivat e përgjithshme dhe qëllimi i programit, është shfrytëzuar një metodologji e punës gjithëpërfshirëse, që në vete ngërthen, përfshirjen e grupeve të ndryshme të interesit, të kyçura në procesin e identifikimit, dokumentimit, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në Komunë.

Baza ligjore

- Ligji për Trashëgiminë Kulturore
- Plani Regjional i Trashëgimisë kulturore Qendër
- Memorandumi i Mirëkuptimit në mes shtatë Komunave Qendër
- Vendimi i Kryetarit të Komunës
- Plani zhvillimor Komunal 2013-2023

Grupet e synuara janë saktësisht zyrtarë të Departamenteve të Urbanizmit, Kulturës dhe Zhvillimit Ekonomik, OJQ-të dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile; nga ana tjetër janë, përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti për Planifikim Hapësinor, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Departamenti i Turizmit, ekspertë të ndryshëm vendas e të huaj, qytetarët, grupet rinore lokale, etj.

Përfshirja e grupeve të ndryshme të interesit në këtë proces dhe hartimi i një Plani Lokal për Trashëgiminë Kulturore, do të ndikojë, në krijimin e ndjenjës së pronësisë ndaj planit, nga një grup më i gjerë, që tejkalon kufijtë zyrtar të institucioneve përgjegjëse, për menaxhimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Në anën tjetër, trajtimi i çështjeve rreth ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, edhe nga përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët jo medoemos janë profesionist të kualifikuar për këtë fushë, do të ndikojnë në ofrimin e qasjes gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrjes demokratike.

Në këtë mënyrë, procesi i identifikimit, dokumentimit, interpretimit, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore do të ndikojë, duke marrë parasysh një opinion dhe qëndrim gjithëpërfshirës, duke debatuar dhe reflektuar haptas rreth mundësive dhe sfidave, që paraqiten para pasurive të trashëgimisë kulturore në komunë, duke konsideruar edhe vlerën e shtuar nga komuniteti dhe në këtë mënyrë, duke njohur rolin e organizatave vullnetare, si partnerë në aktivitete dhe kritikë konstruktiv, të politikave të trashëgimisë kulturore.

Rezultatet e pritura pas realizimit të planit janë:

- Plani Lokal i Trashëgimisë Kulturore, ka identifikuar prioritetet dhe politikat proaktive, për mbrojtjen dhe revitalizimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Komunë.
- Janë zbatuar projekte të investimeve kapitale, që kthejnë në realitet aksionet, aktivitetet, projektet e identifikuar nga Plani.
- Kapacitetet e implementimit në nivel lokal, gjegjësisht kapacitetet e Departamentëve të urbanizmit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik në komunë dhe ato të Qendrave Rajonale të Trashëgimisë Kulturore.
- (niveli qendror) dhe OJQ-ve janë, të përforcuara me qasje në vendimmarrje, përfshirje në dialog, pjesëmarrje dhe trajnime gjatë procesit.

- Komunikimi mes palëve lokale dhe atyre qendrore është konsoliduar.
- Përmirësimi i gjendjes ekzistuese të trashëgimisë kulturore përmes projekteve të investimeve kapitale në tre fusha strategjike: konservimi i integruar, ndërhyrjet emergjente e restaurim dhe vetëdijësim, trajnime e ngritje kapacitetesh.

Analizë mbi gjendjen ekzistuese të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Komunën e Lipjanit

Qëllimi kryesor i analizës së gjendjes ekzistuese të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunë, është që të krijohet një pasqyrë e gjerë e karakteristikave të komunës, duke përfshirë aspektin historik, gjeografik, demografik, ekonomik dhe kulturor.

Hulumtimi i profilit të komunës, do të kontribuonte në kuptimin më të mirë të gjendjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe faktorët që ndikojnë në këtë gjendje.

Metodologjia e punës ka konsistuar në:

hulumtimin në dokumente zyrtare; hulumtimin e literaturës; takime të drejtpërdrejta me zyrtarë dhe përgjegjës institucional; intervistim të profesionistëve që merren me fushën e trashëgimisë kulturore në Komunën e Lipjanit dhe vizitat në terren, për të arritur një analizë të hollësishme të gjendjes ekzistuese të aseteve të trashëgimisë kulturore, në komunën e Lipjanit.

Raporti në vijim, ngërthen informata të rëndësishme rreth Komunës së Lipjanit, duke përfshirë karakteristikat kryesore, prioritetet, dinamikat sociale, ekonominë, analizën urbane, analizën e shpërndarjes së buxhetit dhe specifikat e aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Analiza është pasuruar me Kartat e Trashëgimisë Kulturore, të hartuara në formë tabele, ku paraqiten të dhënat kryesore rreth vendndodhjes së pasurive të trashëgimisë arkitektonike dhe arkeologjike, kohës së ndërtimit, nivelit të dëmtimit, atributet e vlerave, sugjerimet për trajtim.

Informatat e përgjithshme

Komuna e Lipjanit ka pozitë të përshtatshme gjeografike sepse, gjendet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Kufizohet me komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Prishtinë, Drenas, Suharekë, Malishevë, Shtime, Gjilan dhe Artanë.

Territori administrativ i komunës është i pozicionuar në jug të Prishtinës dhe mbulon sipërfaqen prej 338.54 km². Ka mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor – hekurudhor, e përmes Vrellës edhe atij ajror, për shkak se, Aeroporti i vetëm ndërkombëtarë gjendet në territorin e Komunës së Lipjanit dhe është nga qendra vetëm 15 km. Në anën perëndimore, shtrihet rezervati Blinaja, që do të mund të zhvillohej në një qendër rekreative dhe atraktive për tërë rajonin. Në vendbanimin e Gadimes, gjendet Shpella e mermerit, që paraqet një atraksion të rëndësishëm turistik jo vetëm për Komunën e Lipjanit por, për tërë Kosovën. Parku kulturo-historik në Kleçkë dhe Divjakë, si dhe qyteza e vjetër Janjeva, po ashtu konsiderohet si vend atraktiv për vizitorë.

Kjo makro-pozitë e territorit të Komunës, si dhe vetë qytetit Lipjan paraqet rrethanën mjaft të përshtatshme, për zhvillimin e mëtejshëm të Komunës. Përmes territorit të Komunës së Lipjanit, kalon hekurudha e cila, lidhë këtë territor në të gjitha drejtimet me rajonin në tërësi.

Komuna e Lipjanit ka 62 fshatra, ku numër më i madh i tyre, janë të koncentruar në fushëgropën e Kosovës që, paraqet pjesën qendrore të Komunës së Lipjanit, ndërsa vendbanimet e tjera, shtrihen në pjesën lindore dhe perëndimore të kufijve morfologjikë. Në pjesën kodrinore malore të Komunës së Lipjanit, ku një numër i tyre, është i koncentruar në pjesën qendrore, ndërsa të tjerat në pjesën lindore dhe perëndimore të kufijve morfologjikë të Komunës. Gjithashtu kjo Komunë gjendet në afërsi të drejtpërdrejtë të qendrave më të mëdha të Republikës së Kosovës si:


Lipjan – Prishtinë	16 km
Lipjan – Mitrovicë	57 km

Lipjan –Prizren60 km
 Lipjan – Gjakovë96 km
 Lipjan – Pejë (përmes Prizrenit)..... 131 km
 Lipjan – Ferizaj26 km
 Lipjan – Gjilan50 km etj.

Regjioni është një nyje transporti me të vetmin Aeroport ndërkombëtar në Kosovë dhe të gjitha linjat e rrugëve hekurudhore dhe nacionale që përshkon zonën. Autostrada e planifikuar Prishtinë-Hani i Elezit-Shkup kalon nëpër territorin e Komunës, e cila i mundëson qasje Lipjanit edhe në Autostraden e Planifikuar Vërmicë – Mardare.

Qyteti i Lipjanit është i pozicionuar në udhëkryqin në mes të dy rrugëve të rëndësishme 25/E 752 dhe 2/E 65, dhe të hekurudhës kryesore Mitrovicë-Shkup. Me këtë, qyteti është i pajisur mirë me infrastrukturë rrugore dhe pozitë të favorshme në raport me rrethinën.

Për më tepër fshatrat Gadime, Janjevë, Magurë dhe Shalë, duhet të funksionojnë si nën-qendra për zonat përreth. Paraqitja e përgjithshme e komunës mund të përshkruhet si rurale.



Popullsia

Në komunën e Lipjanit jetojnë rreth 57605 banorë, në qytetin e Lipjanit jetojnë rreth 10,000 banorë, ndërsa pjesa tjetër jetojnë në zonat rurale (fshatra). Dendësia e popullsisë 169.59 b/km2, ndërsa dendësia mesatare e popullsisë në shkallë vendi 205 b/km2, 3.2% e territorit të shtetit.

Në bazë të regjistrimit të popullsisë nga ana e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) të kryer më 2011, popullsia totale është 57,605¹.

Popullsia në Komunën e Lipjanit	Gjithsej	Etniteti									
		Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Te tjerë	Preferoj të mos përgjigjen	Te dhënat nuk janë në dispozicion
Total	57,605	54467	513	128	42	342	1812	4	260	4	27

Tabela 1: Popullsia në komunën e Lipjanit sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës 2011.

Dinamikat sociale

Punësimi –

Lipjani ka të punësuar në sektorin publik 1505 punëtor, në sektorin privat rreth 6662 punëtorë, fuqi. Duke iu referuar këtyre të dhënave del se, prej numrit të punësuarve të regjistruar 4,759 janë me shkollë të mesme, ndërsa 4,333 të pakualifikuar. Vlerësohet se edhe në komunën e Lipjanit, papunësia sillet në mesataren e vendit prej rreth 48%.

Të dhënat në lidhje me punësimin sipas veprimtarive, sugjerojnë që industria përpunuese punëson pjesën më të madhe të punëtorëve (rreth 32%), pas saj vjen tregtia me mbi 29%. Numri total i të

punësuarve në aktivitetet e sipërpërmendura vlerësohet të jetë rreth 6662.

Tregu i të papunëve në Kosovë është shumë i lartë, ka shifra që tregojnë se 50% e popullsisë së aftë për punë nuk punon dhe nuk realizon asnjë të ardhur për veten dhe familjen e tij.

Të papunësuar në Komunën e Lipjanit janë gjithsejtë 48.91% prej nga:

- Meshkuj 41%
- Femra 61.33 %

Nga të dhënat parashihet se fuqi punëtore prej 15-64 vjet janë rreth 31002.
punëtore prej 15-64 vjet janë rreth 31002, numri i nxënësve 13396.

Arsimimi –

Statistikat arsimi në komunën e Lipjanit					
<i>Lloji i institucionit</i>	<i>Nr. i shkollave</i>	<i>Nr. i nxënësve</i>	<i>Nr i personelit</i>	<i>Administrator</i>	<i>Punëtor</i>
Qerdhe	2	153	11	2	9
Shkolla Filllore	26 - Amë / 30 - Paralele	11488	675	37	128
Shkolla të Mesme	3 - Amë / 1 - Paralele	3457	173	9	22
Qendra Korrektuese	1	38	4	2	
Gjithësejt	63	15136	863	50	159

Shëndetësia –

Në Komunën e Lipjanit KPSH realizohet përmes këtyre institucioneve shëndetësore :

- Qendra kryesore e Mjekësisë familjare (QKMF)
- Qendra e Mjekësisë familjare (QMF)
- Ambulanca e mjekësisë familjare (AMF)

Gjendja sociale -

Periudha	Numri i familjeve
2010	1559
2011	1501
2012	1281
2013	1243
2014	1250
2015	1157

Ekonomia –

Resurset ekonomike dhe burimet njerëzore të Lipjanit, janë shumë të favorshme për një zhvillim të qëndrueshëm dhe prosperitet ekonomik në shumë lëmenj, sidomos në bujqësi dhe minerale.

Në Komunën e Lipjanit² veprojnë rreth 1645 biznese sipas strukturës:

- Tregti,

- Transport,
- Prodhim,
- Ndërtimtari,
- Hotelieri etj,

Analiza e zhvillimit ekonomik

Aktualisht në komunën e Lipjanit janë të shpallura 4 zona industriale, të cilat janë të shpërndara në pjesë të ndryshme të territorit komunal. Ndër zonat më të mëdha industriale janë:

1. Zona Industriale Lipjan-QMI, e cila është e shpallur si zonë industriale me PZHK 2005 dhe ka 87ha,
2. Zona Ekonomike e njohur me status "Park Industrial", e cila ka një sipërfaqe prej 142ha,
3. Zona Ekonomike e Agrobiznesit "Ulpiana" me sipërfaqe prej 93.8ha,
4. Zona Ekonomike në kuadër të zonës së aeroportit, e planifikuar me PZHK 2005 e cila ka 40ha.

KARAKTERISTIKAT MORFOLOGJIKE - EKSPONICIONI I TERRENIT

Nga të dhënat e përgjithshme të Komunës, me theks relievit të territorit të Komunës së Lipjanit sipas të cilave: pjesa më e madhe e sipërfaqeve, janë rrafshina me 44.53 %, nga ana jugperëndimore 10.98 %, të lindjes 4.03 %, pjesa veriore si më negative është kryesisht në terrenet e larta rreth 5.78 %, verilindore 7.96% dhe veriperëndimore 6.71%.

LARTËSIA MBIDETARE

Territori i Komunës së Lipjanit, gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500m ose 43.0 % të sipërfaqeve (bruto) gjinden në pjesën e rrafshët që do të thotë, gjer në 600 m të lartësisë mbidetare, të cilat janë edhe më të përshtatshme për prodhimtarinë bimë. Kështu që, në kuadër të këtyre sipërfaqeve, gjendet numri më i madh i vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera, si dhe lumenjve me degët e tyre, të cilat përfshijnë rreth 6 % të territorit të përgjithshëm të Komunes.

PASURITË NATYRORE

Komuna e Lipjanit është e pasur me resurse natyrore, të cilat paraqesin bazë të volitshme për zhvillim. Më të rëndësishme janë mineralet, ku më së shumti gjenden në pjesët perëndimore dhe lindore të Komunës ndërsa, pjesa qendrore është e pasur me thëngjill. Mineralet më të rëndësishme të cilat i posedon Komuna janë: Magneziti, Nikeli, Thëngjilli, Zinku, Kromi, Duniti, Rëra, Kuarc dhe Zhavorri.

Komuna e Lipjanit, posedon rreth 25.867 ha sipërfaqe bujqësore, prej së cilës 19.385 ha janë tokë e punueshme – pjellore. Faktorët natyrorë si: pozita gjeografike, morfologjia e terrenit, kushtet klimatike dhe karakteristikat hidrografike, kanë ndikuar në zhvillimin e deritanishëm në aspekt pozitiv të Komunës së Lipjanit.

Analiza e shpërndarjes së buxhetit komunal në fushat e ndryshme

Buxheti komunal, përcakton ndarjen e burimeve të pakta financiare të komunës dhe si e tillë, pjesëmarrja e publikut në zhvillimin e buxhetit komunal, mund të kontribuojë në krijimin e një buxheti, që reflekton nevojat dhe prioritetet e banorëve të komunës dhe demonstroi përkushtimin e komunës.

		2016	2017	2018
1.	Granti i përgjithshëm	4,221,055.00	4,302,395.00	4,399,183.00
2.	Granti për arsim	5,710,828.00	5,710,828.00	5,710,828.00
3.	Granti për shëndetësi	1,361,955.00	1,361,955.00	1,361,955.00
4.	Gjithsej HVK	1,650,000.00	1,870,000.00	1,890,000.00
5.	Gjithsej	12,943,838.00	13,245,178.00	13,361,966.00

Analiza urbane e komunës

Përfshirja e Trashëgimisë Kulturore në planet komunale

Bazuar ne Planin hapësinor të Kosovës, Zona ku bënë pjesë Komuna e Lipjanit është: Aeroporti i Kosovës (Hapësirë e kaltër) – Zonë administrative, arsimore, shëndetësore, shërbyese tregtare, industri e lehtë, agro-industriale, turistike. Në qendër të zonës (trekëndëshi Lipjan-Fushë Kosovë –Prishtinë), parashihet të zhvillohet si TZHEK - Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, si kurriz i zhvillimit ekonomik me interes kombëtar, burim i të ardhurave për ekonominë kosovare, si dhe zonë e mundshme për investitorët e kompanive ndërkombëtare.

Bazuar ne Planin zhvillimor Komunal 2013-2023, I miratuar me vendim te Kuvendit te Komunës së lipjanit, Trashegimia kulturore eshte e trajtuar ne kuadër të fushave tematike, sipas së cilave, jane definuar strategjite per zbatim , si vijon:

- **TURIZMI**

Strategjia 1: Promovimi i Lipjanit si qytet i turizmit rinor dhe kongresial.

Strategjia 2: Promovimi i Janjevës si vendbanim i turizmit kulturorë, historic.

Strategjia 3: Promovimi i Gadimes si vendbanim i turizmit kulturorë, rekreativ.

Strategjia 4: Promovimi i ndërtimit të vikend-shtëpive në zonat e dedikuara për turizëm, të cilat mundë konsiderohen edhe si projekte të bashkëpunimit ndërkufitar Kosovë – IRJ e Maqedoni-së .

Strategjia 5: Promovimi i këtyre vendbanimeve për turizmit rinorë, kulturorë, rekreativ, rural dhe Agroturizëm .

Strategjia 6: Promovimi i trashëgimisë arkeologjike për zhvillimin e turizmit.

Strategjia 7: Krijimi i infrastrukturës turistike .

Strategjia 8: Mbrojtja e natyrës-mjedisit dhe turizmi .

Strategjia 9: Turizmi i gjuetisë.

- **HOTELERIA DHE TURIZMI**
- **ZONAT ME DESTINIM TË VEÇANTË**

Strategjia 1: Sigurimi që zonat me destinim te veçante në nivelin Komunal (të natyrës, vendbanimet dhe zonat tjera) të trajtohen në mënyrë adekuate .

- **TRASHËGEMIA NATYRORE**

Strategjia 1: Mbrojtje e trashëgimisë natyrore.

- **KULTURA**

Strategjia 1: Ofrimi i kushteve dhe përmbajtjeve për ruajtje, konservim dhe përdorim në vazhdimësi të qëndrueshme të trashëgimisë kulturore

- **SPORTI DHE REKREIMI**

Strategjia 1: Ofrimi i përmbajtjeve sportive dhe rekreative në vendbanime, në përputhshmëri me funksionin e tyre dhe hierarkinë.

HISTORIKU I KOMUNËS

Si vendbanim Lipjani njihet që nga koha Ilire e më vonë Romake si pjesë e qytetit Ulpiana, e cila ndodhet në verilindje, në largësi 10km. Lipjani në periudhën romake, ishte kryesisht një vendbanim i vogël në rrugën për në Lisum. Identifikimi i Lipjanit me emrin „Ulpiana” më vonë, është vërtetuar edhe me zbulimet e gërmadhave të antikës së vjetër, të periudhës bizantine.

Nga antika e vjetër emri Lypenion, Lypiana, padyshim vijnë deri te emri i tashëm Lipjan. Nën themelet e kishës ekzistuese, në këtë pjesë, janë zbuluar themelet e bazilikës bizantine, ndërsa nga vet Lipjani janë të njohura disa monumente-epigrafe, prej të cilave vërtetohen të dhënat për ekzistimin e Ulpianës.

Me zhvillimin e industrisë-minierës në vendbanimin e Janjevës, u bë e njohur edhe Prishtina, kështu që Lipjani, humbi rëndësinë e mëparshme dhe funksiononte si një “shesh” i thjeshtë lokal.

Janjeva për herë të parë është përmendur në vitin 1303, me zhvillimin e industrisë së minierave në shek. XIV dhe XV, u ngrit në një qendër të rëndësishme afër Prishtinës dhe Novobërdës (Artanës). Në mes tjerash, qyteti kishte kontakte me Republikën e Raguzës (Dubrovniku) i sotëm në Kroaci.

Njëra nga shkollat e para në Kosovë, është hapur në Janjevë në vitin 1665 dhe përdoret edhe sot e kësaj dite.

Në përgjithësi, deri me ndërtimin e hekurudhës në fund të shek. të kaluar (1873-1874), Lipjani ishte një fshat i rëndomtë, i njohur si kryqëzim i rrugëve në rajon. Në këtë hekurudhë, Lipjani fitoi stacionin hekurudhor, krahas të cilit u ndërtuan punëtoritë e para me karakter tregtar, depot për grumbullimin e drithërave dhe dyqane zejtare, kështu deri në fund të shek. XIX, gjatë kohës së sundimit turk, kjo pjesë e re e Lipjanit fitoi pamjen me karakter qyteze, kurse si qytezë është shpallur në vitin 1920.

Me funksionimin e hekurudhës Kosovë-Maqedoni, qarkullimi kryesisht ishte përmes Greqisë (qyteti i Selanikut- ish Solun), kështu konkurrenca e tregut dhe aktivitetet tregtare, ndikuan në qendrat si: Mitrovica, Ferizaj dhe Lipjan, në dobësimin e tregut në qendrat më të mëdha si Prishtina, Gjakova dhe Prizreni. Që nga kjo kohë fillon të zhvillohet Lipjani. Nga kjo rrjedh se ndikimi i Lipjanit më shumë shtrihet në rrethinën më të afër, si në pjesët perëndimore malore dhe kodrinore dhe kjo jo vetëm në pjesët që përfshijnë kufijtë administrativ, por edhe në pjesët e Drenicës së Epërme, me të cilën Lipjani është afërsisht i vetmi vendbanim me karakter qyteti.

Në anën tjetër, si shembull i gravitimit të Drenicës Jugore krahas Lipjanit, krijohet lëvizja e lirë natyrore. Nga kjo del se Lipjani –pozita gjeografike e tij, paraqet aspekt të gjerë dhe me interes në raport me qendrat më të mëdha.

Lista e Objekteve të Evidentuara- paraqet listën e monumenteve të evidentuara nga përgjegjësit e QRTK-ve në Kosovë, me rastin e hulumtimit në terren. Në Komunën e Lipjanit janë evidentuar 20 objekte.

Lista e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme – paraqet listën zyrtare të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Në këtë listë, në Komunën e Lipjanit gjenden gjithsej 10 lokalitete në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike dhe 10 monumente në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore.

Hulumtimet dhe analizat në terren, janë kryer për 20 monumentet që gjenden në Listën e Trashëgimisë Kulturore, nën Mbrojtje të Përkohshme për vitet 2012-2013.

Në listën e fundit e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme (2015- 2016), në Komunën e Lipjanit janë përfshirë 16 Monumente në kategorinë, Trashëgimia Arkeologjike dhe 14 Monumente në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore, duke e rritur numrin total në 30 Monumente

Lista e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme Lipjan

Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike



Gjendja e objekteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje




Me hulumtimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, është synuar që të merret analiza detaje e gjendjes ekzistuese të aseteve të trashëgimisë arkitekturale dhe arkeologjike të komunës, në kuadër të Planit Lokale të Trashëgimisë Kulturore.



Referencë është marrë Lista Zyrtare e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme, e hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kjo listë ka shërbyer si bazë e hulumtimit në terren .


Lista e objekteve të propozuara si objekte me vlera të trashëgimisë .

Komplekset memoriale - Agjencia per menaxhimin e Komplekseve memoriale të Kosoves.
Ligji Nr.04/L-146 Shtojca 1.



Emertimi	Foto	Pershkrim
1. Kompleksi memorial i ZIV "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë" – Malet e Berishës	  	Zona me interes të veçantë në "Kleçkë dhe Divjakë", përmbanë vlera historike duke u bazuar në ngjarjet e rëndësishme, të zhvilluara gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1998-1999. Kjo zonë reflekton në rëndësinë e një organizimi të mirëfilltë, që ka ekzistuar në radhët e UÇK-së, si faktor vendimtarë, në kurorëzimin e aspiratave të popullit tonë, Pavarësinë e Kosovës. Zona e Interesit të Veçantë "Kleçkë dhe Divjakë" shtrihet në Malet e Berishës, gjegjësisht në fshatin Kleçkë dhe Divjakë - Komuna e Lypjanit, në fshatin Novosellë – Komuna e Malishevës, në fshatin Berishë - Komuna e Drenasit dhe fshati Luzhnicë –Komuna e Suharekës. Sipërfaqja e tashme e zonës me interes të veçantë, është 4038.38 ha, prej të cilës 1633,53 ha ose 41% e sipërfaqes i përket komunës së Drenasit, 1100.74 ha ose 27% e sipërfaqes i përket komunës së Lipjanit dhe 1304.11 ha ose 32% e sipërfaqes i përket komunës së Malishevës.
2. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së		Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe spitali ushtarak Një pjesë e fshatit Divjakë, gjatë periudhës së luftës, ka shërbyer si seli e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Në kuadër të tri objekteve ka vepruar: Drejtoria Operative, Drejtoria e Shërbimit Informativ, dhe Drejtoritë tjera të rëndësishme. Pjesa tjetër e lokacionit të Divjakës ka shërbyer si poligon i Njësisë Speciale të SHP të UÇK-së, ndërsa në një pjesë tjetër të fshatit
3.		

Spitali ushtarak		ka qenë i vendosur Spitali Ushtarak i UÇK-së. Këto objekte nuk janë në gjendje të mirë, kryesisht për shkak të materialit të brishtë ndërtimorë që ka qenë i pambrojtur me kohë dhe për shkak të ndikimit të kushteve atmosferike.
4. Shtabi i Brigadës 121 të UÇK-së “Ismet Jashari - Komandant Kumanova”		Shtabi i Brigadës 121 të UÇK-së “Ismet Jashari - Komandant Kumanova” Në Kleçkë ka qenë selia e Shtabit të Brigadës 121 të UÇK-së “Ismet Jashari-Komandant Kumanova”. Po ashtu në këtë lokacion, ka vepruar edhe një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe janë mbajtur takime të rëndësishme, të udhëheqësve të luftës, me diplomatë evropianë dhe amerikanë. Objekti i dëmtuar me shenja evidente të luftës së vitit 1999, është Shtabi i Brigadës 121 të UÇK-së “Ismet Jashari-Komandant Kumanova”. Objekti zhvillohet në dy etazhe, me një aneks të zgjatur në formë suterani, përdhese dhe kati . Kulmi i objektit është në gjendje të keqe dhe ka ndikuar në dëmtimin e mëtejshëm të strukturës ekzistuese, kryesisht nga veprimi i reshjeve atmosferike.
5. Memoriali i Martirëve në Sllavi		Kompleksi memorial i Dëshmorëve dhe Martirëve të fshatit Sllavi, të rënë me 15 dhe 16 prill 1999 nga forcat paramilitare serbe.
6. Memoriali i Martirëve në Ribar të Vogël		Kompleksi memorial i Martirëve në Ribar të Vogël, i ngritur në shenjë të përkujtimit të rënies së martirëve nga forcat serbe me 18 prill 1999 në fshatin Ribar të Vogël. Me këtë rast ranë 19 martirë, dhe atë prej moshës 9 vjeçare deri në moshën 82 vjeçare

7. Memoriali i Martirëve në Hallaq i Vogël		Kompleksi memorial i 20 martirëve të rënë me 19 prill 1999 ne Hallaq të Vogël .
8. Memoriali i Martirëve në Dobrajë e Madhe		Pllakë përkujtimore në shenj nderimi per martirët e rënë në prag të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në vitin 1912 nga forcat serbe ne Dobrajë të Madhe . Pllaka përkujtimore u zbulua me rastin e 100 vjetorit te Pavarësisë së Republikës së Shqipërisë.
9. “Qendra Memoriale Monumentale e Rambujesë” ne Shalë		28 nëntor 2010 Ky monument është përruar me 28 nëntor 2010 , në shenjë të përkujtimit nga vendi ku u nis delegacioni I UÇK-së, për të marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare të Rambujesë në Francë. Me rastin e përrimit, mori pjesë ish-Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu dhe me këtë rast Komuna e Lipjanit e shpalli qytetar nderi i Komunës së Lipjanit.
10. Varrezat e Martirëve Vërshec- Blinajë		Lapidar në shenjë të përkujtimit të martirëve të familjes Vuniqi dhe Qadraku, qe ranë gjatë luftes 1998-1999, në fshatin Ribor i Vogël

11. Memoriali i masakrës “Masakra e Bujanit” Bujan		Kompleksi memorial i martirëve ne Bujan, të rënë në prag të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912
12. Memoriali i “Dëshmorëve të Krojmitit”		Pllakë përkujtimore e 4 Dëshmorëve të UÇK-së nga Kroimiri: Enver Olluri, Isa Olluri , Halil Metaj, Qamil Olluri në Kroimir. Me krenari SHMU e fshatit Kroimir e mban emrin e këtyre katër Dëshmorëve






Bunari i
familjes
Olluri,
Krojmir -
Lipjan.






LISTA E TRASHEGIMISË KULTURORE NËN MBROJTJE TË PËRKOHSHME


Kategoria : Trashëgimi arkeologjike




Nenkatëgoria . Lokalitet arkeologjik





Nr	Emertimi i lokacionit	Fotot	Përshkrimi
1	Qyteza parahistorike (Gradina) Gadime e Eperme - parahistori Kodra e Murturit Gadime Pllakë memoriale Gadime	  	Shek V-III Gadime e Epërme Lokaliteti Gradishtë gjendet mbi një sukë në pjesën perëndimore të maleve të pasura me xehe të Zhegovcit. Kodër e rëndësisë së veçantë Në shenjë përkujtimi të rënjes së Dëshmorëve dhe Martirëve nga Gadimja ,në luftat e ndryshme për liri ,çlirim dhe bashkim kombëtar.
2	Lokaliteti arkeologjik "Ograje" Rubovc Antikitët i vone mesjete	 	Shek IV. Sipas disa burimeve, është vendbanim që nga koha e Neolitit. Në këtë vendbanim, ka ekzistuar një Kishë Ilirë – shqiptare, e periudhës së perandorisë romake. Bunari i vjetër në Sheshin e fshatit Rubovc Shekulli XIX- të.

3	Qyteza Kodra e „Gjytetit” Baicë		Shek IV Në Baicë gjendet një lokalitet i tipeve kështjellore – qytetare ,lokaliteti gjindet në maje të kodreës së „Gjytetit”, në jugperëndim të fshatit Baicë Kolshit të Drenices jugore. „Gjyteti” ka strategji interesante e mbështetur në kulturen materiale dhe në strategjinë e terrenit ,mund të kemi një lokalitet të tipit kështjellor ilir.
4	Qyteza ne Kleçkë		Shek .IV Në livadhet e Kleçkës, një lopogermadhë quhen „Trojet e Kleçkës” ku ka shenja të vendbanimit të vjetër ,i cili është zhdukur, në dokumentat e vjetra të asj periudhe kohore quhej Kelaçica .
5	Germadhat e kishes “shen Xhoni’ Sillovi		Mesjetë shek XVI (Manastir)
6	Germadhat e Kishes se “Shen Nikolasit”		Mesjete shek XVI




7	Germadhat e manastirit mesjetare "Shen Gjergji" Sllovi		Mesjetë shek XIV
8	Kisha varrezore e fshatit Topliqan		Kishë varrezore ne Topliqan , Mesjetë XVII
sht 9	Qyteza e Janjevës		"Qyteza me një hyrje dhe një dalje." Janjeva është vendlindja e Hilës (Shtjefën Gjeçovi) Kryevepra e tij, Kanuni i Lekë Dukagjinit. Sipas dokumenteve mesjetare, Janjeva zihet në gojë për herë të parë në një letër të Papës Benedikti IX, dërguar Marinit, kryepeshkop i Tivarit, që mban datën 18. XI 1303. Qyteti në fjalë përmendet ndër shtatë xeherore të njohura të argjendit(3). Gjatë mesjetës nëpër të kalonte rruga "Shkodër-Prizren"(e Zetës) e cila vinte nga pjesa e rrafshit të Kosovës për Novobërdë dhe me tutje në lindje. në vitin 1328 e kishte parodinë e vet katolike. Në vitin 1433 në Janjevë, përmenden edhe tregtarët dubrovnikas të cilët këtu ishin edhe më herët dhe merreshin me xehetari. Në këtë kohë Janjeva ishte qendër e njohur xehetare, kështu që në vitin 1488, e kishte edhe Ligjin e vet të xehetarisë. Në vitin 1929 bëhen ndryshime administrativo-territoriale. Në Mbretërinë jugosllave formohen banovinat. Janjeva ishte në kuadër të Rrethit të Graçanicës, i cili ishte në kuadër të Banovinës së Vardarit me qendër në Shkup.


	Kisha e Shën Kollit Janjevë		
--	--------------------------------	--	--

Emërtimi	Foto	Përshkrim
Minierat	  	Gjurmët e Minjerave të periudhës Iliro –romake në Janjevë.

Emërtimi	Foto	Përshkrim
Kisha Katolike Peshter (Brus)	    	Figura e Shën Masjanit Kisha e ndërtuar më 1935 Shekulli XX-të. Në kuadër të Kompleksit të Kishës, funksionojnë edhe Konaqet e Kishës .

Trashegimia Arkitekturale
Nenkategoria : Monument ansambel

Emërtimi	Foto	Përshkrim
Kisha e Shpalljes së Virgjreshes Lipjan. 		Shek XIII- XIV Zonë e Veçantë e Mbrojtur.
Bunkeri i Luftes së II-të Botërore, Vrellë.		Viti 1958 , - Lufta e II-të Botërore Intervenimi: Restaurim i përgjithshëm. Rregullimi i stusit pronësor.

Tyrbja e Isak Babës		Shek XVIII Supozohet te jete e vjeter rreth 500 vite , nje ushtare i cili ka mbrojtur popollaten është vrare në këtë vend. Intervenimi: Restaurim i pergjithshëm.
Xhamia në Shalë		Shek . XVIII
Shtëpia Muze e „At Shtjefën Gjeçovit “ Janjevë.		Shek .XX E restauruar në vitin 2004, nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporti dhe Komuna e Lipjanit.
Kulla e Pashë Karadakut Janjevë		

Shtëpia e Paliq Lipa, Janjevë.





Shtëpia me ballkon-Gllasnoviq
Josipa Marija.




Shek.XIX

Shtëpia e Aziz Hamdi Ollurit ne
Kroimir.

Shtëpia z/ Aziz (Hamdi) Olluri, e cila
sherbeu ne funksion të spitalit ushtarak.
Gjate periudhes se Luftes se Ushtrisë
Çlirimtare te Kosoves, në Krojmir, kanë
shërbyer mbi 15 persona te personelit
mjeksor dhe janë shëruar, me dhjetra
ushtar dhe me qindr banorë te kësaj ane.



Xhamia e Janjevës






Shek. XVIII


E restauruar nga TIKa 2015


Objekte te Te propozuara per mbrojtje ne nivel lokal.


Trashëgimi arkeologjike		
Lokacioni arkeologjik Torine		Periudha romake
Lokacioni arkeologjik Babush		Periudha romake
Lokacioni arkeologjik "Gradina ' Bujan		Periudha romake
Trashëgimi arkitekture		
Kompleksi turistik "Anija" Janjevë		Objekt ne kuadër të Zonës turistike të Janjevës - vend atraktiv i turizmit kulturor. Pjesë e projektit për zhvillimin e turizmit rural, në Komunën e Lipjanit.
Shtëpi banimi në Mirenë.		Shek XIX.
Shtëpi banimi ne Risinofc.		Daton nga shek XVIII.

Gryka e Shalës-Shalë.		Gryka e Shalës. Monumenti përkujtimor dhe pllaka, janë dëshmi që perkujtojnë vendin e mbijeteses se popullates civile, gjate luftes se UÇK 98 -99 ne Gryken e Shales . Në këtë vend ndrroi jetë, edhe kryefamiljari Vehbi Meta (Shamolli) dhe me këtë rast, familja Shamolli ngriti këtë monument, të trashëgimisë së luftes se fundit.
Mulliri i ujit në Kroimir		Ne baze te gojedhanave te banoreve te fshatit Kroimir, mulliri ka qenë pronë e 4 vllzerve mirëpo, me rritjen e vellazerise se ketij trangu familjar, mulliri ka mbetur pronë e perbashket dhe ka filluar të shfrytëzohet me rend (orar) .Ndersa lagjet tjera te fshatit , apo familjet, nuk kanë pasur rend apo orar te shfrytezimit (vetem per nevoja familjare).
Xhamia në Magurë		Shek XX




Shtëpia e kulturës – Vrellë e Goleshit.		Shtëpi e Kultures e ndertuar pas Luftes se dyte boterore, me punë vullnetare nga komuniteti lokal për nevoja të rinisë dhe qytetarëve.
Shtëpia e kulturës, Grackë e Vjetër.		Shtëpi e Kultures e ndertuar pas Luftes se dyte botërore, me punë vullnetare nga komuniteti lokal, për nevoja te rinisë dhe qytetarëve.
Shtëpia e kulturës Lipjan.		Objekti i shtëpisë së Kulturës në Lipjan, është ndërtuar gjatë vitit 1947-48, me punë vullnetare te qytetarëve të kësaj treve. Shtëpia e kulturës, veprimtarinë e vet, e ka zhvilluar si kompleks kulturor, për permbushjen e nevojave kulturore te rinisë dhe qytetarëve të komunes.
Shkolla e parë shqipe në Janjevë.		Shkolla e parë shqipe në Kosovë, u hap në janjevë, me iniciativën e andrea Bogdanit kryepeshkop i Peshkopatës së Shkupit, ku për mësues të parë, u emërua Don Pjetër Mazreku. Shkolla filloi veprimtarinë e vet në vitin 1665.
Mulliri i ujit , Shalë		Mulliri i ujit ne Shale , prone e familjes Hoxha .


		
Shtëpia e Mehdi Qeriqit , Kroimir.		Në këtë shtëpi u organizuan njësitet e para të UÇK- së gjatë vitit 1998.
Mejtepi Topliqan.		
Shkolla 4 vjeqare në fshatin Banullë.		Shkolla Fillore në Banullë, vend i takimeve të shumta të veprimtarisë politike, gjatë kohës së okupimit 1991 - 1989 .
Hani i Sinanëve dhe Mulliri i ujit Resinofc.		Për mullirin dhe Hanin e Sinanëve , nuk dihet sakt koha e ndërtimit, besohet se është para 1800 –tës, i cili paraprakisht kishte qenë pronë e familjes Dermaku dhe sipas tregimeve të të parëve, është thënë se nga kjo familje, për arsye të panjohura, ka mbetur vetëm një grua, Naile Dermaku, si pronare e cila ka gjetë mbrojtje të familja më e madhe në fshat , ajo e Sinanëve. Pas vdekjes së saj kanë emërtuar një vajzë të tyre me të njëjtin emër , në kujtim të të saj. Ndërsa objektet janë në pronësi të Siannëve, që nga viti 1870 e deri ketë ditë, që momentalisht janë në gjëndje të mjerueshme dhe jofunkionale.




		Objekti i Hanit –funksioni. Hani në etazhën e parë , ka qenë shitore mallrash dhe vend për të pirë dhe ngrënë, ndërsa etazha e dytë dmth kati 1 , ka qenë bujtinë për udhëtarët. Momentalisht objekti ka vetëm muret periferike. Objekti I mullirit –Përbëhet prej jazit (prrockës për furnizim me ujë me gjatesi prej 850 m , parcela per furnizim per mbushjet e “tantes” dhe parcela e mullirit ku gjendet mulliri. Vlen të theksohet se , jazi është përdorë edhe për vaditje dhe ky është një symbol I fshatit, I cili gjatë periudhës së paraluftës shpeshherë, ka bashkuar kmunitetin vendas për hapjen e këtij kanali, një lloj qëndrese kundrejt vështirësive të asaj kohe. Gjendja momentale mullirit është e shkatërruar . Në brendesi, gjenden gurët originalë dhe pjesa e poshtme nga gurët identik, të cilët presin një dorë për ti rijetësuar.
Qeshmja e Hasimit dhe mrizet në Kraishtë.		Mrizet, kane sherbyer për pushim të bagëtive ne mesditë, kur vapa ishte në kulmin e dites.
Kroni i Kleçkës		I ndërtuar nga Beqir Shala 1986.
Qeshmja e Brahës Sllavi.		Qeshmja, ka shërbyer për ujë të pijshëm dhe freskim të udhëtarëve të cilët në kohërat e mëhershme udhtonin në këmbë për tu shërbyer në vendbanimet përreth dhe qytetet e afërta.




		
Qeshmja dhe bunari në Topliqan.		Këto dy burime të ujit, u shfrytëzuan nga qytetarët e Topliqanit për ujë të pijshëm, prej kohërave më të lashta historike.
Kroni i kallugjerit ne Sllovi.		
Mulliri i ujit në Sllovi (manastir).		





Memorialet




Emertimi	Foto	Pershkrim
Memorial i martirëve Kraishtë.		Memorial I ngritur nga Komuna e Lipjanit më 2016, në shenjë perkujtimi për martirët e rënë, gjatë luftës së fundit më 1999 : Behram Bajrami, Gëzim Bajrami, Lulzim bajrami,. Tahire Lacaj, Nase Kodra, Lavdim Kodra në Kraishtë.
Memorial i martirëve Ribar i Madhë.		Memorial perkujtimor, në nderim të martirëve: Ajet Kozhani, Beqir Duriqi, Brahim Hoti, Fahri Zari, Nuhi Kozhani, Hamdi Hoti, Vahide Kozhani, Adelina Kozhani, në varrezat e fshatit Ribar i Madh i ngritur nga Komuna e Lipjanit.
Lapidari i Banush dhe Ibrahim Hoxhes në Shalë.		Lapidari i ngritur në shenjë të perkujtimit të jetës dhe vepres atdhetare, të Banush dhe Ibrahim Hoxha në Shalë.

Lapidari i Haxhi Korpuzit në Shalë.		Lapidari I ngritur në shenjë nderimi për martirin e parë të luftës së UÇK-së 1998.
Lapidar i Afërditë Qeriqit.		Lapiar I ngritur në shenjë perkujtimi të rënies së martires së kombit Afërditë Sh. Qeriqi, në ofensivën e parë të luftës së UÇK 1998.
Pllaka perkujtimore e Xhevat Rexhepit .		Pllakë perkujtimore në shenjë nderimi për veprimtarin dhe atdhetarin Xhevat Rexhepi, i cili ra heroikisht në shtëpinë e tij 1999.

Lapidar i i Ali Sherif Kadrija.		Lapidar ne shenjë të përkujtimit të rënies se Ali Sherif Kadrija. Vendi te çeshmja e Hasimit .
Lapidari i deshmorit te UÇK-së Xhavit Kozhani – „Burgia” .		Lapidari I ngritur ne shenjë të përkujtimit te rënjes heroike në Blinajë, të deshmorit te UÇK-së, Xhavit Kozhani – (Burgia), në Ribar të Madhë.
Lapidar i martirëve ne Qylagë.		Lapidar I ngritur ne shenjë të përkujtimit të martirëve:Xhevdet Bytyçi, Nebih Bytyçi në Qylagë.
Lapidar I deshmorit Haradin Bajrami – „Dinamiti”.		Lapidar I ngritur ne shenjë përkujtimi në Rreze , të deshmorit të kombit, te Luftes se UÇK-së , i cili ra heroikishtë në Blinajë me 2 prill 1999. Haradin Bajrami – „Dinamiti”.




Pllakë përkujtimore për martiret: Rrahim Bytyçi , Enver Fazliu.		Pllakë përkujtimore e ngritur në shenjë përkujtimi për martirët: Rrahim Bytyçi , Enver Fazliu 19.04. 1999.
Pllakë përkujtimore për martirët Mirenë.		Pllakë përkujtimore për martiret e kombit: Arif Zeneli (01.05.1999) Skender Zeneli (20.03.2000), Hajzer Zeneli (04.02.2000), Zade Zeneli (12.08.1998), Elmije Zeneli (12.08.1998). Mirenë
Pllakë përkujtimore, Uran Amërllahu në Gryke te Shales.		Pllakë përkujtimore ne vendin e renies së Uran Amërllahu (01.06.1999) nxenes i SHMU Idriz Ajeti në Shalë, i cili ra në Grykë të Shalës.
Pllakë përkujtimore heroit te popullit, Emin Duraku		Pllakë përkujtimore e periudhës së Luftës së Dytë Botërore në shenjë nderimi të heroit të popullit, Emin Duraku 1943. Pllaka e ngritur me 7 korrik 1951, në anen e djathtë të rrugës magjistrale Lipjan -Shtime.
Lapidari I dëshmorit, Lulzim Llugiqi.		Lapidar i ngritur në shenjë përkujtimi, për dëshmorin e kombit Lulzim Llugiqi – Dobrajë e Madhe, i cili ra heroikisht


		me 5 qershor 1999, në kufirin shqiptaro-shqiptarë në Koshare.
Pllakë perkujtimore për martirin, Xhevdet Breznica		Pllakë perkujtimore e ngritur në shenjë nderimi për martirin Xhevdet Breznica, i cili ra në demonstratat – protestat e vitit 1989.
Pllakë perkujtimore për ushtarin e UÇK, Lulzim Morina,		Pllakë perkujtimore në shenjë nderimi, për ushtarin e UÇK-së, Lulzim Morina më 10.12.2000.
Pllakë perkujtimore për martirin, Salih Fetahu.		Pllakë perkujtimore në shenjë nderimi për martirin Salih Fetahu, i rënë më 19.04 1999, në Rufe të Ri.


Pllakë përkujtimore dëshmoresh së kombit, Zylfije Gashi		Pllakë përkujtimore ne shenjë nderimi të dëshmoresh së kombit, Zylfije Gashi 16.04.1998 ne Terbovc.
Pllakë përkujtimore për martirët: Shyqeri Qamili, Arton Rexhepi.		Pllakë përkujtimore e ngritur në shenjë nderimi, për martirët: Shyqeri Qamili, Arton Rexhepi të rënë gjatë luftes së UÇK-së.
Pllakë përkujtimore, për heroin, Ismet Asllani.		Pllakë përkujtimore e ngritur në shenje nderimi për heroin e luftes së UÇk-së Ismet Asllani –Lipjan , rruga magjistrale Pr-Prizren.

Trashëgimia natyrore

Lista Nr.71/-6 nga IKMN Iniciativa per shpalljen e vlerave të natyrës në mbrojtje .


Vendi	Nr.	Vlera e evidentuar e natyres	Foto	Kategoria e mbrojtjes sipas IUCN (propozim nga IKMN)
Baicë	1	Trungu i dushkut afër Shkollës		Monument natyre (me karakter botanik) III
	2	Trungu i dushkut në varreza		Monument natyre (me karakter botanik) III
	3	Burimet e ujit në Baicë		Monument naatyre (me karakter hidrologjik) III
	4	Burimi i ujit natyral (Burimi mbi hurdhen e peshqve)		Monument naatyre (me karakter hidrologjik) III
Shalë	5	Guri I shpuar		Monument natyre (me karakter gjeomorfologjik)

Kroimir	7	Guri te kroni		Monument natyre (me karakter gjeomorfologjik).
Vrellë	8	Burimi I ujit natyral "Vrella"		Monument natyre (me karakter hidrologjik) III
Blinajë (Fsh Vershevc)	9	Trungu i dushkut ne varreza		Monumant natyre (me karakter botanik) III
Blinajë	10	Blinaja		Zonë menaxhuese e habitateve ,ose llojeve të mbrojtura IV.

Qylagë	11	Trungu i dushkut afër shkollës		Monumant natyre (me karakter botanic) III
Dobraj e Madhe	12	Trungu i dushkut në varreza.		Monumant natyre (me karakter botanic) III
Poturovc	13	Trungu i dushkut në Poturovc.		Monumant natyre (me karakter botanic) III
Torinë	14	Pylli I dushkut		Pejsazh I mbrojtur V
Bregu I Zi	15	Trungu i dushkut afër rrugës		Monumant natyre (me karakter botanic) III
	16	Pylli i dushkut në varrezat e vjetra.		Pejsazh i mbrojtur V

Bujan	17	Pylli i dushkut në varreza.		Pejsazh i mbrojtur V
Gadime e Ultë	18	Shpella e mermertë te xhamia		Monument natyre me karakter gjeomorfologjik III Shpella e Gadimes gjendet në fshatin Gadime në afërsi të Lipjanit, Kosovë . Ajo është e gjatë 1500 metra, miirëpo, për turistët është i mundshëm shikimi i vetëm 1300 metrave të para të shpellës, pasi që, për pjesën tjetër të shpellës, ende nuk janë të mundshme kalimet. Ne Shpell, janë kati i mesëm, që është për vizitor, kati nënujor dhe kati i sipërm. Gjatë verës, temperatura në brendi të shpellës, është konstante 13 gradë celsius dhe gjatë dimrit 11-13 gradë.
	19	Pylli në kodrën mbi xhami.		Pejsazh I mbrojtur V
Gadime e Epërme	20	Trungu i dushkut në varreza		Monument natyre (me karakter botanic) III
Smallushë	21	Tre lisat e dushkut afër shkollës		Monument natyre (me karakter botanic) III

	22	Trungu i dushkut dhjetra metra larg tre lisave afër shkolles.		Monument natyre (me karakter botanik) III
Smallushë	23	Trungu i qarrit ne varreza		Monument natyre (me karakter botanik) III



Prezentim i Trashëgimise natyrore - PZHK

SWOT Analiza e përgjithshme

SWOT analiza , është një mjet për vlerësim të gjendjes ekzistuese, e cila shërben për të mbledhur ide të Ndryshme, nga përfaqësuesit e sektorit të caktuar, të cilët marrin pjesë në procese në mënyrë aktive.

PERPARËSITË	DOBËSITË
-Dominimi i strukturës së re të popullsisë -E pasur me vlera të trashëgimis kulturore Lipjani,Janjeva etj, natyrore; Gadimja,Blinaja etj,Historike; zona Kleqkë, Divjakë dhe arkeologjike -Ekzistimi i zonës së Aeroportit -Ekzistimi i peizazheve natyrore -Ekzistimi i zonave të mbrojtura, (Blinaja, Shpella, Zona Kleqkë – Divjak, Lipjan etj) -Ekzistimi i zonave të pasura të trashëgimisë . Pozita e volitshme gjeografike, në raport me kryeqytetin dhe me qytetet. -Ekzistimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, prodhuese, shërbyese etj. -Ekzistimi i kushteve për turizmin rural. -Ekzistimi i zonave dhe objekteve turistike të trashëgimisë. -Ekzistimi i kapaciteteve hoteliere dhe bujtinave. - Prania e investitorëve të huaj -Zonat industriale ekzistuese dhe disa zonave tjera, për zhvillim ekonomik dhe pozicioni i tyre, në kuadër të Trekëndëshit të zhvillimit ekonomik të Kosovës. -Ekzistenca e burimeve natyrore. - Pozita gjeografike e përshtatshme, strategjike duke patur parasysh, që komuna gjendet në udhëkryq të disa rajoneve. -Organizimi i tradicional "Takimet e Gjeçovit". - Qasja e lehtë deri te monumentet kryesore. - Vetëdija e ngritur për trajtimin e TK.	- Migrimi rural-urban i shquar, por edhe jashtë komunës së Lipjanit . -Mos harmonizimi i profilin arsimor me nevojat të ekonomisë . - Mos trajtimi dhe shfrytëzimi adekuat i vlerave të trashëgimisë. -Mungon efikasiteti për menaxhimin e zonave dhe monumenteve të mbrojtura. -Ngulfatja dhe shkatërrimi i zonave me vlera kulturo- historike. nga ndërtimet pa leje . -Mungesa e politikave për ruajtjen e zonave me trashëgimi kulturo-historike, në bazë të koncepteve bashkëkohore. - Zhvillimet e pakontrolluara te zona e aeroportit,zona ku nxirret lënda e parë për Feroniklin,afër shpellës së Gadimes etj . -Mungesa e infrastrukturës dhe shërbimeve në zonat tjera, të mundëshme për zhvillimin e turizmit rura.l -Mos shfrytëzimi adekuat i parkut të Blinajës dhe shpellës së Gadimës . -Mos shfrytëzimi adekuat i trashëgimis , si qyteti i argjendët Janjeva dhe zona Kleqkë – Divjakë. - Pjesëmarrja jo gjithëpërfshirëse, në procesin e planifikimit hapësinore dhe ruajtjes të trashëgimisë kulturore. - Bashkëpunimi në nivel jo të kënaqshëm ndër institucional dhe numri i pamjaftueshëm i ekspertëve. -Vetëdija e ulët ndaj trashëgimisë kulturore dhe natyrore. - Mungesa e promovimit adekuat të TK-së. - Mosekzistimi i të dhënave të sakta, të aseteve kulturore-historike. -Mungesa e tabelave udhëzuese për trashëgiminë kulturore. - Përfshirja e pamjaftueshme e TK-së në planet hapësinore dhe urbanistike. - Buxheti i pamjaftueshëm për TK. - Ndotja e lumenjve dhe shkatërrimi i shtratit të

	lumenjve. - Mungesa e politikave të informimit dhe ndërgjegjësimit, për TK-në(mungesa e një qendre informuese),punësimin e personave të specializuar për TK(të shtohet numri i tyre).
MUNDËSITË -Shfrytëzimi i trashëgimisë për zhvillim ekonomik - Partneritetet në mes të niveleve qeverisëse dhe sektorit privat . -Krijimi i identitetit nëpër mjet vlerave kulturore,natyrore,historike dhe arkeologjike. -Nxitja e turizmit dhe zhvillimit ekonomik. -Hartimi dhe zbatimi i projekteve nga niveli qendror dhe komuna ,për vlerat e trashëgimisë kulturore Lipjani,Janjeva etj,natyrore; Gadimja,Blinaja etj,Historike; zona Kleqë – Divjakë dhe arkeologjike. -Digjitalizimi,Planifikimi dhe përgatitja e projekteve për mbrojtje dhe zhvillim të zonave me vlera arkeologjike . -Planifikimi ishfrutëzimit të programeve të ndryshme ndërkombëtare, për menaxhimin, promovimin dhe zhvillimin e peizazheve dhe zonave tjera të trashëgimisë natyrore(Blinaja). -Zhvillimi dhe planifikimi i zonës së kleqë, Divjakë dhe hapësirave përreth. -Zhvillimi dhe planifikimi i zonës së Blinajës. -Zhvillimi dhe planifikimi i zonës së shpellës së Gadimës -Promovimi i kapaciteteve dhe resurseve turistike. - Fuqizimi i identitetit të komunës së Lipjanit në fushën e turizmit. -Mbrojtja e vlerave kulturore historike. -Shfrytëzimi i kapaciteteve nga diaspora, (joshja e investuesve)krijimi i partneriteteve. - Projekte të nivelit të Kosovës dhe Ndërkombëtare, për Janjevën. - Revitalizimi i objekteve kryesore të TK-së ,në nivelin komunal. - Shfrytëzimi i objekteve të TK në funksion të aktiviteteve kulturore. - Zhvillimi i turizmit natyror dhe rekreativ. - Vendosja e tabelave udhëzuese (sinjalistika). - Përcaktimi i zonave (historike) të mbrojtura në Lipjan. - Promovimi i TK-së me qëllim të vetëdijesimit për rëndësinë e TK-së dhe ngritjes së nivelit të trajtimit të TK-së.	RREZIQET - Deekuilibrim demografik për shkak të shpërnguljes së lartë, nga disa vendbanime të Lipjanit. -Shkatërrimi i kulturës,traditës dhe vlerave -Vështirësitë në zhvillim ekonomik. -Shkatërrimi dhe zhdukja e trashëgimisë - -Shkatërrimi i vlerave kulturore,natyrore, historike, arkeologjike etj. -Degradim deri te shkatërrimi i vlerave dhe zonave të trashëgimisë - Humbje e identitetit,trashëgimisë dhe lashtësisë -Degradim deri te Shkatërrimi i vlerave dhe zonave të peizazheve.

- Partneriteti publiko –privat për projektet që kanë të bëjnë me TK. - Hulumtimi i trashëgimisë shpirtërore të komunës së Lipjanit. - Zhvillimi i turizmit kulturore urban dhe rajonal. - Zhvillimi i sporteve në lidhje me natyrën(hiking, alpinizëm, çiklizëm etj.)	
--	--

SWOT Analiza strategjike

SWOT analiza e përgjithshme u pasua me SWOT-in Strategjik, që është një analizë më specifike dhe ka për qëllim kryesor që atributet negative, pra dobësitë dhe rreziqet, t'i shndërroj në attribute pozitive.

Objektivat:

- Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e TK përmes pasurimit të materialit, informativ (mediave të shkruara,elektronike, broshurave udhëzuese etj.).
- Përforsimi i kapaciteteve institucionale, në nivel qendror dhe lokal, përmes ofrimit të mundësive për ngritje profesionale.
- Përmirësimi i kornizës ligjore për trajtimin e TK-së, përmes proceseve gjithëpërfshirëse dhe transparente.
- Ndalimi i ndërtimeve të pa planifikuara, në afërsi të objekteve të TK-së.
- Ngritja e TK në prioritet të lartë të qeverisë dhe institucioneve tjera përgjegjëse.
- Integrimi i TK në jetën e përditshme, shfrytëzimi i saj për përfitime ekonomike në të mirë të komunitetit.

Objektivat e përgjithshme dhe prioritizimi i projekteve

1. Mbrojtja dhe konservimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore , trajtim i objekteve historike dhe zonave të trashëgimisë natyrore.
2. Integrimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore, në jetën bashkëkohore dhe zhvillimi lokal përmes saj .
- 3.Trajtim hapësinor dhe zhvillimor i trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
4. Edukim, trajnim, vetëdijesimi mbi trashëgimin kulturore dhe natyrore , aspekti human mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Periudha e konsultimeve publike

Prioritetet dhe projektet e identifikuara në komunën e Lipjanit

- Mbrojtja dhe konservimi i Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore .
- Trajtimi i objekteve historike dhe zonave të trashëgimisë natyrore.
- Integrimi i Trashëgimisë Kulturore në jetën bashkëkohore dhe zhvillimi lokal, përmes Trashëgimisë Kulturore , trajtim hapësinor dhe zhvillimor i Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore.
- Edukim, trajnim, vetëdijesim mbi Trashëgiminë Kulturore, aspekti human mbi Trashëgiminë Kulturore dhe Natyrore.

PLANI I VEPRIMIT – ZBATIMI I PROJEKTEVE

	Implikimi financiar	Afati kohor	Autoritetet
Projektet ne kuadër te strategjive .	I ulte deri 20.000€, i mesem 20,000.00-150.000 i larte mbi 50.000	Afatshkurter 1-3 vite Afatmesem 3-5 vite Aftgjate mbi 5 vite	
Promovimi i Lipjanit si qytet i turizmit rinor dhe kongresial			
Gjatë hartimit të planeve, rregullues, HZK dhe te tjera, duhet planifikohet infrastruktura për këtë lloj turizmi në qytetin e Lipjanit dhe të filloj kompletimi i infrastructures, me masa stimuluese (hapësira për takime, punë, konferenca, hotele etj).	I MESËM	AFATMESE	KOMUNA, PRIVAT dhe INVESTITORËT
Krijimi i një sistemi të përgjithshëm informativ turistik (hartat, fletëpalosjet, Web faqja...)	I ULTE	AFATMESE	Komuna , MKRS , MAPH, Bizneset ,OJQ-te ,Donatoret .

Ndërtimi i qendrës së kontaktit dhe një bordi për turizëm, që do ta promovonte atraksionin turistik brenda Komunë.	I MESEM	AFATGJATË	Komuna , MKRS , MAPH, Bizneset ,OJQ-te ,Donatoret.
Hulumtime dhe studime të fuqizimit të potencialeve ekzistuese dhe të planifikuara për aktivitete turistike.	I MESEM	NË VAZHDIMËSI	Komuna , MKRS , MAPH, Bizneset ,OJQ-te ,Donatoret
Strategjia 2 : Promovimi i Janjevës si vendbanim i turizmit kulturor, historik			
Projekte për promovimin e Janjevës, si njëra ndër pikat potenciale per turizem .	I MESEM	NË VAZHDIMËSI	Komuna , MKRS , MAPH, Bizneset ,OJQ-te ,Donatoret
Përgatitja e projektit për promovim, propagandim dhe reklamimin e shtëpisë së Shtjefën Gjeqovit.	I ULTË	AFATSHKURTËR	Komuna , MKRS , MAPH, Bizneset ,OJQ-te ,Donatoret
Renovimi i shkollës, njërës nga shkollat e para shqipe në Kosovë	I ULTË	AFATSHKURTER	Komuna , MKRS , MAPH, Bizneset ,OJQ-te ,Donatoret
Strategjia 3: Promovimi i Gadimes si vendbanim i turizmit kulturorë, rekreativ			
Kompletimi dhe zbatimi i projekti të Amfiteatrit të hapur.	I MESEM	AFATMESEM	Komuna , MKRS , MAPH, Bizneset ,OJQ-te ,Donatoret
Projekte për promovim, propagandim dhe reklamim të vlerave të shpellës së Gadimes.	I ULTË	AFATSHKURT	Komuna , MKRS , MAPH, Bizneset ,OJQ-te ,Donatoret
Kompletimi dhe zbatimi i projekti të Kalasë.	I MESEM	AFATMESEM	Komuna , MKRS , MAPH, Bizneset ,OJQ-te ,Donatoret
Strategjia 4 : Promovimi i ndërtimit të vikend-shtëpive në zonat e dedikuara për turizëm, të cilat mundë të konsiderohen edhe si projekte të bashkëpunimit .			
Përgatitja e projekteve për nën zonat e destinuara për vikend-shtëpi, në kuadër të zonës për Turizëm Rekreativ, të Gjuetisë dhe Shëndetësor në Akllap dhe Brus.	I LARTE	I MESEM	KOMUNA, PRIVAT, DHE INVESTITORET
Strategjia 5 : Promovimi i këtyre vendbanimeve për turizmit rinorë, kulturorë, rekreativ ,rural dhe agroturizëm.			
Janjeva (Turizmi kulturor dhe njëra ndër shkollat e para shqipe në Kosovë). Kleçka dhe Divjaka (Trashëgimia kulturo historike).Krojmir dhe	I MESEM	AFATSHKURT	KOMUNA DHE INVESTITORET

Shalë (turizëm rekreativ). Gadimja (turizëm kulturor dhe rekreativ. Janjeva dhe Lipjani (turizëm kulturor "Kisha e Shën Florit dhe Kisha e Notradamit"). Lipjani, Gadime (Trashëgimi kulturor historike si dhe mundësi të mira për turizëm kongresial.			
Strategjia 6 : Promovimi i trashëgimisë arkeologjike për zhvillimin e turizmit			
Komuna me aprovimin e këtij plani, i shpallë të mbrojtura të gjitha zonat arkeologjike të prezantuara në këtë plane, pas një përnjohje fillestare.	I ULTË	AFATSHKURTER	KOMUNA DHE INSTITUCIONET QENDRORE
Komuna do të vazhdoj me incizimet gjeofizike të trenit, me prioritet në zonë Urbane (zonë e Gadimes).	I MESEM	NE VAZHDIMESI	KOMUNA, INVESTORET DHE INSTITUCIONET QENDRORE
Strategjia 7 : Krijimi i infrastrukturës turistike			
Ndërtimi i infrastrukturës bazike turistike, duke përfshirë infrastrukturën e transportit, telekomunikimit, akomodimit dhe varësisht nga zona infrastrukturën specifike relevante për zonën ku mundë të përfshihen edhe shtigjet për bjeshkatari, ecje apo kalërim, poligonin për shenjëtari si kompletimin dhe fuqizimin e infrastrukturës sidomos në zonat me vlera të shquara natyrore dhe të trashëgimisë kulturore .	I LARTE	NE VAZHDIMESI	KOMUNA, INVESTORET DHE INSTITUCIONET QENDRORE
Një sistem i përshtatshëm informativ për shfrytëzimin e këtij rrjeti, i përbërë prej hartave, fletëpalosjeve dhe mjeteve tjera informuese, do të duhej ta përkrahte zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, në varshmëri nga resurset e ndryshme .	I ULTË	AFATMESEM	KOMUNA
Një web faqe për resurset dhe mundësitë turistike të Lipjanit në trajtë të ofertës, do të mund të ndihmonte në tërheqjen e interesit për investime në zhvillimin e turizmit .	I ULTË	AFATMESEM	KOMUNA
Bordi i turizmit, do të krijojë qendrat informative turistike. Në fillim qendra informative turistike duhet	I MESEM	AFATMESEM	KOMUNA

të krijohet në qytetin e Lipjanit ,ndërsa ato pasuese do të mund të krijoheshin në Gadime, Magure, Kleçk.			
Strategjia 8 : Mbrojtja e natyrës-mjedisit dhe turizmi			
Promovimi i natyrës dhe mjedisit, si resurs për turizëm. Pasi që në plan, janë siguruar dhe prezantuar të gjitha të dhënat të nevojshme për lokacionet e monumenteve të mbrojtura të natyrës,(Bimë, gjeomonumente, burime ujore) dhe zonave të mbrojtura natyrore, aktiviteti i parë në këtë strategji është shenjzimi dhe futja nën mbrojtje.	I MESEM	AFATSHKURTER	Komuna dhe investitoret
Hotelleria dhe turizmi			
Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore sipas planit të zonave turistike, për ndërtimin me një standard dhe cilësi të lartë I objekteve hoteliere, objektet për vendosje (bujtje) dhe objektet për ushqim dhe pije .	I LARTE	AFATGJATE	KOMUNA DHE INVESTITORET
Hartimi i projekteve ideore dhe kryesor, për mbrojtje të veçantë, për burimet ;kroni i kuq, shavarinat në Shalë, burimet natyrore në Krojmir, vrella e ngrohtë Baicë, akumulimi i ujërave në lumin Drenicë.	I ULTE	AFATSHKURT	KOMUNA DHE INVESTITORET
ZONAT ME DESTINIM TË VEÇANTË Strategjia 1: Sigurimi që zonat me destinim te veçantë, në nivelin Komunal (të natyrës,vendbanimet dhe zonat tjera) të trajtohen në mënyrë adekuate .			
Përgatitja e projekteve sensibilizuese, propaganduese dhe reklamuese përkatëse, për Klçkën dhe Divjakën, Blinajën, Janjevën dhe Gadimen.	I LARTE	NE VAZHDIMESI	INSTITUCUIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Përkufizimi, piketimi dhe sinjalizimi i zonës së mbrojtur në nivel të Kosovës sipas Planit të Ahtisarit për Kishën e “Shën Florit”	I ULTE	AFATSHKURTER	INSTITUCUIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Përgatitja e projektit për zhvillim të zonës së Kishës së “Shpalljes së Virgjëreshës së Shenjt”konform destinimit të paraparë dhe normave e rregullave.	I MESEM	AFATMESEM	INSTITUCUIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET

Zhvillimi i mekanizmave të përcjelljes të zbatimit dhe kontrollit.	I ULTE	NE VAZHDIMESI	INSTITUCIIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
TRASHËGEMIA NATYRORE			
Strategjia 1: Mbrojtje e trashëgimisë natyrore			
Përgatitja e projekteve për sensibilizimin, propagandimi, dhe reklamimi e zonave, objekteve dhe gjërave me vlera të rralla natyrore si ;Shpella e Gadimes, Rezervati I Blinajës.	I ULTE	AFATSHKURT	KOMUNA
Përgatitja e vendimeve për shpalljen, si të mbrojtura,të ruhen, sensibilizohen, mbrohen dhe konservohen, trungjet e vjetra dhe monumente gjeomorfologjike.	I ULTE	AFATSHKURT	KOMUNA
Strategjia 1: Ofrimi i kushteve dhe përmbajtjeve për ruajtje, konservim dhe përdorim në vazhdimësi të qëndrueshme ,të trashëgimisë kulturore			
Projektet per parandalimin e dukurive aktuale, që cenojnë trashëgiminë kulturore me masa teknike,profesionale dhe legale (të prezantuar në hartën "Trashëgimia Kulturore").	I ULTE	AFATMESEM	KOMUNA, INVESTITORET, NIVELI QENDROR
Shenjëzimi i zonave,objekteve dhe vlerave të trashëgimisë, nga hartat në hapësirë në tërë territorin e komunës së Lipjanit.	I ULTE	AFATMESEM	INSTITUCIIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Incizimi gjeodezik; xhamia mesjetare në Gadime te Ulët, Qyteza në Gadime, Teqja në Teqe-Janjevë, „Gjyteti" në Bainsë dhe Kleçkë, lokacioni arkeologjik në Rubovcë, Kisha e "Noterdamit" Lipjanë, rrënojat e kishave "Shën Xhoni", "Shën Nikolasit" dhe "Shën Xhergjit" në Sllovi.	I MESEM	NE VAZHDIMESI	INSTITUCIIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Hartimi i projekteve kryesore dhe fillimi i zbatimit në funksion të shpëtimit, rehabilitimit dhe përdorimit të vlerave kulturore ,historike dhe me dobi kulturore-shoqërore, ekonomike, shkencore, edukative, ekologjike dhe të turizmit kulturor;	I MESEM	NE VAZHDIMESI	INSTITUCIIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Mbrojtja dhe përgatitja e projektit të ri të zhvillimit të Kishës së Shpalljes së Virgjëreshës së Shenjtë me zonën mbrojtëse.	I MESEM	AFATMESEM	INSTITUCIIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Kampanjë informuese dhe marketingu	I ULTE	AFATMESEM	INSTITUCIIONET

në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve komunale, në funksion të trashëgimisë dhe të imazhit të vendit, me përfitime shumë dimensionale;			QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Futja në listën e Vlerave dhe marrja nën përkujdesjen institucionale, e përmendoreve të dëshmorëve të luftës së UÇK-së	I ULTE	AFATSHKURTER	INSTITUCUIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Krijimi i një mekanizmi komunal, për kontroll të zhvillimeve për të gjitha vlerat e trashëgimisë.	I ULTE	AFATMESEM	INSTITUCUIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Projekti për rivitalizimin e Shtëpisë së Kulturës në Lipjan dhe e njëjta të jetë në funksion, vetëm të jetës kulturore.	I ULTE	AFATMESEM	INSTITUCUIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Krijimi i hapësirave dhe kushteve për biblioteka, në lokalitetet e parapara me Plan.	I MESEM	AFATMESEM	INSTITUCUIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Krijimi i kushteve për funksionimin e ansambleve dhe shoqërive Kulturo artistike dhe themelimin e të rejave.	I ULTE	AFRATMESEM	INSTITUCUIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Përgatitjet e projektit ideorë, kryesor dhe fillimi ,zbatimi i një Teatri të hapur , në Janjevë, në Gadime dhe në Lipjan.	I MESEM	AFRATGJATE	INSTITUCUIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET
Përgatitjet projekti ideore, Kryesor dhe të filloj zbatimi, për kthimin pamjes së njërës prej Shkollave të para shqipe në Kosovë, ajo në Janjevë dhe fuqizimi i saj si muze.	I MESEM	AFATGJATE	INSTITUCUIONET QENDRORE, KOMUNA DHE INVESTITORET

JUSTFIKIM E VEPRIMEVE DHE SHPJEGIMI I REZULTATEVE TE PRITSHME

Plani për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore, mbulon periudhën 2017-2020. Komisioni, ka përgatitur propozimet, për projektet në kuader të Strategjive , zbatimi I të cilave rezultojnë në arritjen e synimeve zhvillimore, të përcaktuara në fushat kyqe, detyrimet e akvitetëve, bartesit kryesor , afatin kohor të implementimit, përgatitjes dhe koordinimit të aktivitetëve të përgjithshme për implementimin e projekteve.

Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e projekteve të planifikuara, duhet të formohet Bordi për Turizëm apo sektor i veçant, nga fusha e Trashëgimisë natyrore dhe kulturore, i cili do të jetë përgjegjës, për koordinimin e të gjitha aktivitetëve të planifikuara.

Bordi për Turizëm , apo sektori i vecant nga fusha e Trashëgimisë natyrore dhe kulturore, është një organ i përhershëm, që do të formohet me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të projekteve dhe detyrave nga Plani, si:

- Rishikimin e Planit dhe Planit të Veprimit

- Mbështetjen e Kryetarit të Komunes për marrjen e vendimeve që lidhen me zhvillimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe programet lokale , që mbështesin fushën e trashëgimisë.

MONITORIMI

Procesi i monitorimit do të përfshijë këto aktivitete:

- Shkalla e suksesit të Planit , në krahasim të Planit të Veprimit.
- Planifikimi i fondeve dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore.
- Ndryshimet e mundshme, të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve (individët, organizatat).
- Ndryshimet e jashtme, që mund të ndikojnë në Planin e Veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjidhjeve, të ndikuara nga faktoret tjere- harmonizimi.

Plani është hartuar në mënyrë që, mund të matet dhe të monitorohet.

Monitorimi është një tipar i domosdoshëm, për shkak se ai siguron që veprimet, janë zbatuar dhe se përpjekjet, janë duke u kryer, për të siguruar përshtatjen me ndryshimet në burimet e disponueshme dhe të nevojshme.

Pas përfundimit të çdo projekti, në mënyrë transparente do t'i komunikohet publikut mbi statusin.

Projektit - të paktën në përmbajtje:

- Cilat janë qëllimet,
- Cilat janë treguesit e performancës,
- Cila është rëndësia e projektit të realizuar.

Për këtë ,do të raportohet çdo vit Kryetarit të Komunës dhe do të zhvillohet vlerësimi i performancës.

PËRPUTHJA E PROGRAMEVE ME PLANET ZHVILLIMORE TË KOMUNËS

- Harmonizuar me PZHK dhe Planin Regjional i Trashëgimisë kulturore Qendër.

15Nr. 011-41555
Lipjan më 01. 08. 2017

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

